



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

(Projekt)

LIGJ

Nr. _____ datë _____

PËR URDHËRIN PROFESIONAL TË ARKITEKTËVE

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Objekti i ligjit

Objekti i këtij ligji është krijimi dhe përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Urdhërit Profesional të Arkitektit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2

Qëllimi i ligjit

Qëllim i këtij ligji është:

- a) Krijimi i Urdhërit Profesional të Arkitektëve në Republikën e Shqipërisë;
- b) Përcaktimi i kriterëve për organizimin dhe funksionimin e Urdhërit të Arkitektëve në funksion të mbrojtjes së interesit publik, duke respektuar parimin e shqyrtimit të pavarur dhe autonomisë profesionale.
- c) Mbrojtja dhe garantimi i standardeve në formimin dhe ushtrimin e profesionit të arkitektit.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për çdo person, i cili kërkon të ushtrojë profesionin e rregulluar tëarkitektit në Republikën e Shqipërisëqoftë ky vendas apo i huaj.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtem kanë këto kuptime:

- a) «UPA» : Urdhëri Profesional i Arkitektëve në Republikën e Shqipërisë ;
- b) «Rregullorja e UPA» : është e përbërë nga tërësia e rregullave që duhen zbatuar nga çdo anëtar i UPA, të cilat garantojnë mirëfunksionimin sipas standardeve etike dhe profesionale, në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- c) « Arkitekt Profesional » : është çdo arkitekt i regjistruar në UPA në kategorinë përkatëse të përcaktuar në Rregulloren e UPA ;
- d) «Profesion i rregulluar i arkitektit » : është një veprimtari apo grup veprimtarish profesionale, e drejta e ushtrimit të të cilave ose njëra nga format e ushtrimit, rregullohet me këtë ligj dhe me aktet nënligjore dhe kushtëzohet me një nivel të caktuar formimi ose me zotërimin e kualifikimeve profesionale në fushën specifike tëarkitekturës.
- e) « Kualifikime profesionale » : janë kualifikime arkitektit tëvërtetuara me njëdokument zyrtar të formimit dhe njëdëshmi të përvojës profesionale.
- f) « Dokument zyrtar i formimit » : është diploma e lëshuar nga autoriteti kompetent, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, qëvërteton përfundimin e formimit profesional tëarkitektit, të zhvilluar brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
- g) « Veprimtari profesionale » : është ushtrimi i profesionit tëarkitektit për një periudhë të caktuar kohore.
- h) « Praktika profesionale » : është ushtrimi i profesionit për një periudhë të caktuar kohe nga ana e arkitektit praktikant, nën drejtimin dhe përgjegjësinë e një profesionisti të kualifikuar, që mund të shoqërohet me një formim shtesë, sipas mënyrës së përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore nëfuqi.
- i) « Regjistri » : është regjistri profesional i të gjithë anëtarëve të regjistruar në UPA, ku secili ka kodin e tij dallues, identitetin e tij, shoqëruar me nivelin e kualifikimit dhe referencat. Këto informacione do të jenë të hapura për publikun.
- j) « Provimi i Shtetit » : është kontrolli vetëm për njohuritë profesionale të praktikantit, që organizohet në përputhje me Rregulloren e UPA dhe legjislacionin në fuqi. Ky provim kryhet sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren e UPA dhe legjislacionin në fuqi, dhe vlerëson njohuritë dhe aftësitë e Praktikantit për ushtrimin e një profesioni të rregulluar.
- k) « Kandidat » : është personi fizik, i cili gëzon një dokument zyrtar të formimit profesional dhe që kandidon për të marrë titullin e profesionit të rregulluar tëarkitektit.

KREU II

Organizimi dhe funksioni i UPA-së

Neni 5

Statusi i UPA-së dhe Logo

- 1- UPA është ent publik kombëtar, jo buxhetor, i pavarur, i cili përfaqëson interesat e përbashkëta të personave që ushtrojnë Profesionin e Rregulluar të Arkitektit dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.
- 2- UPA rregullon mënyrën me anë të së cilës praktika profesionale mbron sigurinë dhe interesat e publikut.
- 3- UPA përdor logon zyrtare të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë krahas logos së tij.

Neni 6

Organet e UPA-së

Organet e UPA-së janë:

- 1 Asambleja e Përgjithshme;
- 2 Këshilli Kombëtar;
- 3 Këshilli i Disiplinës.

Neni 7

Funksioni i UPA-së

UPA ka autonomi të plotë financiare, funksionale, administrative dhe është i pavarur në vlerësimin dhe gjykimin e veprimtarisë të çdo anëtari të UPA, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Organizimi i brendshëm i UPA-së përcaktohet me rregullore të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të UPA.

Veprimtaria e UPA-së drejtohet nga Këshilli Kombëtar i përbërë nga arkitektë, sipas kritereve të përcaktuara në Rregullore.

KREU III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Neni 8

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, Kuorumi dhe Vendimet

Asambleja e Përgjithshme, thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje ose me email që duhet t'iu dërgohet anëtareve të paktën 50 (pesëdhjetë) ditë përpara mbledhjes. Njoftimi do të publikohet në Web-sitin e Këshillit Kombëtar si dhe të paktën një herë në një gazetë kombëtare sipas afateve si më lart.

Njoftimi duhet të përmbajë informacion mbi llojin e asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë, të dytë dhe të tretë.

Në thirrjen e parë, vendimet e Asamblesë, janë të vlefshme nëse:

- Janë të pranishëm 1/3 (një e treta) e anëtarëve me të drejtë vote, kur anëtarët e regjistruar në Regjistër i kalojnë 1500 (një mijë e pesëqind).
- Janë të pranishëm 50% (pesëdhjetë përqind) e anëtarëve me të drejtë vote, kur anëtarët e regjistruar në Regjistër nuk i kalojnë 1500 (një mijë e pesëqind).

Në thirrjen e dytë, vendimet e Asamblesë, janë të vlefshme nëse:

- Janë të pranishëm 1/5 (një e pesta) e anëtarëve me të drejtë vote, kur anëtarët e regjistruar në Regjistër i kalojnë 1500 (një mijë e pesëqind).
- Janë të pranishëm 1/4 (një e katërta) e anëtarëve me të drejtë vote, kur anëtarët e regjistruar në Regjistër nuk i kalojnë 1500 (një mijë e pesëqind).

Në thirrjen e tretë, vendimet e Asamblesë, janë të vlefshme pavarësisht numrit të anëtarëve me të drejtë vote të pranishëm.

Procedurat e votimit përcaktohen sipas Rregullores së miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar.

Të drejtën e votës në Asamblenë e Përgjithshme e kanë arkitektët e regjistruar në Regjistrin e Arkitektëve Profesionistë të UPA, me përjashtim të arkitektëve të pezulluar nga ushtrimi i profesionit, të votuar nga grupimet rajonale për të fituar statusin e anëtarit të Asamblesë së Përgjithshme. Mënyra e organizimit të këtyre zgjedhjeve përcaktohet nga Rregullorja e miratuar nga Asambleja.

Asambleja e Përgjithshme do të drejtohet nga Kryetari i UPA dhe në rast mungese nga Këshilltari më i madh në moshë midis të pranishmëve.

Funksionet e Sekretarit përmbushen nga Sekretari i Këshillit të UPA, ose në mungesë tij, nga me i riu në moshë midis Këshilltarëve të pranishëm.

Asambleja e Përgjithshme vendos me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm. Në rast votash të barabarta, mbizotëron ajo e Kryetarit të Asamblesë.

Votimi do të jetë i hapur, përveç se kur Asambleja, me propozim të Kryetarit apo të paktën e një të dhjetës së të pranishmëve, vendos që të bëhet votim i fshehtë.

Forma e votimit elektronik është e lejuar.

Neni 9

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve është përgjegjëse për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, miratimin e bilancit të UPA dhe miratimin e rregullores së UPA.

KREU IV

KËSHILLI KOMBËTAR i UPA-së

Neni 10

Përbërja dhe Zgjedhja e Këshillit Kombëtar

Këshilli Kombëtar përbëhet nga 25 (njëzet e pesë) anëtarë që do të qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh.

Anëtarët e Këshillit Kombëtar përfaqësojnë të gjithë arkitektët e regjistruar në Regjistrat e arkitektëve profesionistë dhe zgjidhen ndërmjet këtyre të fundit.

Anëtarët e Këshilli Kombëtar qëndrojnë në detyrë për një periudhë prej 5 (pesë) vitesh dhe nuk mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

Këshilli Kombëtar thërret një mbledhje të veçantë për miratimin, me votën e shumicës së anëtarëve të pranishëm, të listës së personave që kanë kandiduar për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit Kombëtar.

Lista e personave që kanë kandiduar për t'u zgjedhur si anëtarë të Këshillit Kombëtar i njoftohet Ministrisë si dhe publikohet në faqen Web të Këshillit Kombëtar.

Procedurat e votimit përcaktohen sipas Rregullores së miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar.

Neni 11

Veprimtaria e Këshillit Kombëtar

Mbajtja e Regjistratit të arkitektëve profesionistë dhe funksionet disiplinore gjatë ushtrimit të profesionit të Arkitektit, do të realizohen nga Këshilli Kombëtar i UPA.

Këshilli Kombëtar administron buxhetin e UPA në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Burimet e financimit janë:

- Kuotizacioni i anëtarëve;
- Donacione të ndryshme;
- Të ardhura të tjera të ligjshme.

Të ardhurat e realizuara gjatë veprimtarisë, UPAi përdor për të përmbushur misionin e tij të caktuar me këtë ligj.

Këshilli Kombëtar zgjedh ndërmjet anëtarëve të tij një Kryetar, me të drejte rizgjedhjeje. Kryetari ka të drejtën e përfaqësimit të Këshillit Kombëtar, thirrjes dhe drejtimit të mbledhjeve të Këshillit Kombëtar, si dhe të gjitha kompetencat e përcaktuara në Rregullore.

Këshilli Kombëtar emëron një nga anëtarët e tij me detyrën e Sekretarit dhe një nga anëtarët e tij me detyrën e arekëtarit. Roli dhe funksioni i tyre përcaktohen në Rregullore.

Vendimet e Këshillit Kombëtar merren me shumicë votash, dhe janë të vlefshme vetëm kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij.

Neni 12
Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Kombëtar të UPA-së

Këshilli Kombëtar i UPA-së me selinë Tiranë, të përcaktuar nga Këshilli i Ministratve ka kompetencë:

- Organizimin dhe koordinimin e UPA-në nivel kombëtar sidhe organizimin e procesit zgjedhor të këtyre të fundit;
- Hartimin e kodit etik profesional;
- Përcaktimin e rregullave për anëtarësim sipas kriterëve të përcaktuara në këtë ligj;
- Përcaktimin e niveleve të kualifikimit të anëtarëve;
- Përcaktimin e kuotës së anëtarësisë;
- Ushtrimin e kompetencave mbi procedurat disiplinore;
- Dhënien e informacionit për publikun në fushën e veprimtarive profesionale;
- Dhënien e opinioneve për Qeverinë, Parlamentin dhe organet e tjera shtetërore apo publike;
- Dhënien e opinioneve teknike përfundimtare për Prokurorinë, Gjykatën si dhe për organet e tjera ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë;
- Mbikëqyrjen periodike në ushtrimin e veprimtarisë etiko-profesionale të anëtarëve;
- Organizimime kurseve lidhur me formimin dhe kualifikimin profesional të anëtarëve;
- Hartimin e kurrikulave të Provimit të Shtetit nëpërputhje me fushën e veprimtarisë profesionale dhe me programin e studimit universitar përkatës;
- Vendosjen për krijimin e organeve këshilluese të brendshme;
- Vendosjen për krijimin e marrëdhënieve me partnerë të tjerë jashtë Republikës së Shqipërisë apo anëtarësimin në organizma ndërkombëtare me interes dhe në funksion të punës së tij;
- Propozimin për ndryshim në legjislacionin në fuqi;
- Administrimin e buxhetit të UPA në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.

Neni 13
Ankimet pranë Këshillit Kombëtar të UPA-së

Ankimet para Këshillit Kombëtar mund të paraqiten brenda një afati prej 30 ditësh nga data e marrjes dijeni të vendimit objekt ankimi.

Ankimi duhet të përmbajë argumentat mbi bazën e së cilave mbështetet dhe bashkë me ankimin duhet të paraqiten:

- a) kopje të vendimit të ankimuar, në formën e kërkuar me ligj;
- b) kopje të dokumentave të tjera në mbështetje të ankimit, në formën e kërkuar me ligj.

Procedurat për shqyrtimin e ankimit përcaktohen në Rregullore.

Këshilli Kombëtar vendos në lidhje me ankimin me shumicë votash dhe në raste barazie vendos vota e Kryetarit.

KREU V
KËSHILLI DISIPLINOR

Neni 14

Zgjedhja dhe kompetencat e Këshillit disiplinor

1. Pranë Këshillit Kombëtar funksionojnë Këshillat Disiplinorë, të cilat zgjidhen prej tij për të shqyrtuar mbi shkeljet e teknikës profesionale, të kodit të etikës, si dhe gabimet teknike gjatë ushtrimit të profesionit nga anëtarët e UPA. Këshillat disiplinorë janë organe që verpojnë mbi bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe i propozojnë Këshillit mbi shkeljet e konstatuara.
2. Këshillat disiplinorë janë të ngarkuar me detyrat e edukimit dhe vendimmarrjen e çështjeve disiplinore në lidhje me anëtarët e regjistruar dhe praktikantët.
3. Ndalohet papajtueshmëria midis pozitës së këshilltarit të urdhërit me pozitën e këshilltarit të këshillit përkatës të disiplinës.
4. Këshillat disiplinorë, përbëhen nga tre anëtarë. Përcaktimi i Kryetarit dhe Sekretarit bëhet nga Këshilli Kombëtar.

Neni 15

Gjykimi disiplinor

1. Gjykimi disiplinor kryhet pas sinjalizimit të marrë nga Këshillat Disiplinorë ose i kërkuar nga një palë e tretë.
2. Përgjegjësia e marrjes së masave disiplinore mbi profesionistët e regjistruar në UPA, ushtrohet nga Këshilli Kombëtar, që përbëhet nga profesionistë me kualifikimet e nevojshme për të siguruar përfaqësim të përshtatshëm, pa favorizim dhe pavarësi.
3. UPA, për gjykimin disiplinor mbështetet kryesisht në:
 - a) rregullat proceduriale për efikasitetin e ushtrimit të masave dhe për favorizimin e përfundimeve të shpejta dhe të drejta për gjykim;
 - b) lejimin e apelimit të masave të Këshillit Disiplinor në Këshillin Kombëtar;
 - c) mundësinë e vëzhgimit në gjykimet disiplinore të Ministrisë kompetente, kur ka të bëjë me gjykime juridike;
 - d) Rregulloren e hartuar nga UPA, si dhe në procedurat që garantojnë zhvillimin korrekt të funksioneve të ngarkuara nga UPA në organizimin e tyre-

Neni 16

Masat disiplinore

1. Masat disiplinore të shkeljeve të detyrimeve të parashkuara në këtë ligj janë:
 - a) paralajmërim, që konsiston në një vërejtje të shkruar dhe komunikuar të interesuarit;
 - b) pezullim, që konsiston në ndalimin e ushtrimit të profesionit për një periudhë jo më shumë se dy vjet;
 - c) përjashtim, që konsiston në përjashtimin dhe fshirjen nga Regjistri i UPA-së.
2. Profesionisti i përjashtuar mund të kërkojë të reregjistrohet në Regjistrin profesional jo më parë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të vendimit për përjashtim.

3. Masat disiplinore që merren ndaj një profesionisti duhet të jenë proporcionale me shkallën e shkeljes së ligjeve në fuqi apo kodit etik profesional.
4. Kallëzimi penal në rastet e shkeljes së rëndë dhe me pasoja të etikës profesionale.
5. Proçedurat për të cilat shqyrtohen masat e ndryshme disiplinore përcaktohen në Rregulloren e UPA-së.

Neni 17
Ankimimi

1. Ankesat kundër vendimeve për marrjen e masave disiplinore, paraqiten në Këshillin Kombëtar të UPA, brenda 30 ditëve nga komunikimi me shkrim i vendimit.
2. Këshilli Kombëtar brenda 30 ditëve nga marrja e ankesës, detyrohet të japë mendim për ankesën e paraqitur, lënien në fuqi apo rrëzimin e saj.
3. Në rastin e lënies në fuqi, Ankimesi brenda 30 ditëve, ka të drejtë të ankimohet në Gjykatë kundër vendimit të Këshillit Disiplinor.

KREU VI
REGJISTRI PROFESIONAL I UPA-së

Neni 18
Regjistri Profesional i UPA-së

Regjistrohen në Regjistrin e arkitektëve profesionistë individët që kanë përfutur diplomat përkatëse nga institucionet e shkollimit të lartë të autorizuara me ligj për t'i lëshuar, janë kualifikuar në provimin e Shtetit për ushtrimin e profesionit të arkitektit, gëzojnë të drejta civile dhe nuk janë të dënuar sipas legjislacionit penal në fuqi.

UPA do të përcaktojë nivelet e ndryshme të kualifikimit të anëtarëve të vet të regjistruar, që i korrespondon niveleve të autoriteteve për ushtrimin e aktivitetit profesional, si dhe është në të njëjtën linjë me kuadrin rregullator në fuqi (sistemin e dhënies së licencave).

Regjistri i arkitektëve profesionistë administrohet nga Këshilli Kombëtar.

Për çdo të regjistruar, Regjistri do të përmbajë: emrin, mbiemrin, atësinë dhe vendbanimin. Regjistrimi në Regjistrin bëhet sipas rendit alfabetik. Për çdo emri do të shënohen data dhe lloji i titullit që aftëson ushtrimin e profesionit, me udhëzimet e mundshme të autoritetit që e ka lëshuar, si dhe datën e regjistrimit. Kush është i regjistruar në Regjistrin duhet t'i komunikojë Këshillit Kombëtar, nëpërmjet letrës rekomande, ndryshimin e mundshëm të vendbanimit.

Për të ushtruar profesionin e arkitektit, duhet të kryhet regjistrimi në Regjistrin e arkitektëve profesionistë.

Ekspertiza dhe detyrat e tjera të lidhura me objektin e profesionit të arkitektit janë nën autoritetin juridik që i është njohur të regjistruarve në Regjistrin profesional.

Kur administratës publike i nevojiten shërbimet e arkitektëve apo që ushtrojnë profesionin e lirë, do t'ia besojnë detyrën të regjistruarve në Regjistrin profesional.

Megjithatë, për arsye nevoje apo dobie të dukshme, ekspertizat dhe detyrat e tjera të lartpërmendura, mund t'i ngarkohen personave me kompetencë teknike, qoftë edhe të pa regjistruar në Regjistrin profesional, brenda kufijve të lejuar apo normave që do të vendosen me rregulloren e UPA.

Forma dhe përmbajtja e Regjistrit tëarkitektëve profesionistë miratohen me vendim tëUPA-së.

Kërkesa për regjistrim nëRegjistrin e arkitektëve profesionistë do të paraqitet pranë Këshillit Kombëtar, së bashku me dokumentat e përcaktuara në Rregullore.

Brenda një afati tre mujor Këshilli duhet të vendosë në lidhje me kërkesën për regjistrim.

KREU VII

Detyrat, të drejtat dhe etika e anëtarit tëUPA-së

Neni 19

Detyrat dhe të drejtat e anëtarit të UPA-së

Anëtari i UPA gjatë ushtrimit të profesionit ka për detyrë:

- a) Të respektojë aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe kodin etik profesional;
- b) Të bëjë publik regjistrimin e profesionit të tij;
- c) Të vërë në dijeni Këshillin Kombëtar për situatat e mundshme të konfliktit të interesit;
- d) Të respektojë Rregulloren dhe tarifat profesionale ;
- e) Të përditësojë në vazhdimësi aftësitë e tij profesionale ;
- f) Të paguajë detyrimet e anëtarësimit nëUPA.

Anëtari i UPA gjatë ushtrimit të profesionit të tij ka të drejtë:

- a) Të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha strukturat e UPA-së, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në dispozita të veçanta.
- b) Të marrë pjesënë të gjitha veprimtaritë e UPA-së për përmbushjen e qëllimeve të saj sipas Rregullores.
- c) Të kërkojë nga organet drejtuese tëUPA-së informim për çdo çështje që ka të bëjë me veprimtarinë e UPA.
- d) Të gëzojë të drejtën e mbrojtjes nga UPA në rastin e shkeljes së të drejtave të tij gjatë ushtrimit të profesionit nga kushdo, qoftë edhe ngaanëtarëtëUPA apo profesionistë të huaj që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Përgjegjësitë e anëtarit tëUPA-së

Profesionisti duhet:

- a) të respektojë aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi dhe kodin etik profesional;
- b) të sillet konform dinjitetit dhe nderit profesional;
- c) të kujdeset për përditësimin e aftësive të tij profesionale;

Neni 21
Kodi etik profesional

1. UPA në ushtrimin e veprimtarisë së tij profesionale udhëhiqet nga kodi etik profesional, i cili hartohet dhe publikohet nga UPA, sipas përcaktimeve në Ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.
2. Kodi etik profesional përditësohet nga UPA.

Neni 22
Sigurimi për përgjegjësinë profesionale

1. Anëtari i UPAduhet t'i bëjë të ditur klientit, në momentin që pranon detyrën, kufirin e policës së sigurimit për përgjegjësinë profesionale sipas akteve ligjore në fuqi.
2. Sigurimi i përgjegjësisë profesionale duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë ata që janë të vetë-punësuar, si edhe për ata që bëjnë trajnime, ekskluzivisht jashtë Universitetit, që paguhen nga të tretët.
3. Pasojat disiplinore të dhunimit të detyrimeve sipas pikës 1 të këtij neni parashikohen në akte ligjore në fuqi dhe nëKodin etik profesional.

Neni 23
Ruajtja e titullit dhe edukimi i vazhdueshëm

1. Profesionisti për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e shërbimit profesional, në interesin më të mirë të përdoruesit dhe të komunitetit, si dhe për të arritur qëllimin e zhvillimit profesional, është i detyruar të kujdeset për përditësimin e vazhdueshëm dhe konstant të kompetencave profesionale në përputhje me dispozitat e këtij neni të shtrirane mënyrë periodike,që konsistojnë në pjesëmarrjen në:
 - trajnime, artikujtë shkruar, pjesëmarrje në hartimin e legjislacionit të fushës, futjen e teknologjive të reja, hartimin e kurrrikualve të Provimit të Shtetit apo tëFakulteteve tëarkitekturës nëlëndët profesionale, pjesëmarrje dhe referime në konferenca e seminare që trajtojnë tema që lidhen direkt ose indirekt me fushën përkatëse.
 - Profesionistët për mos plotësimin e krediteve brënda afatit të përcaktuar në Rregullorei nënshtrohen testit të kontrollit të njohurive të përditësuar, organizuar nga Këshilli Kombëtar i UPA-së.
2. Këshilli Kombëtar ose KëshilliDisiplinor, me Rregullore, brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji përcakton:

- a) modalitetet dhe kushtet për përmbushjen e detyrimit për të rinovuar anëtarët për menaxhimin dhe organizimin e aktivitetit të përditësimit;
- b) aktivitetin e trajnimit që kryhet nga UPA, mund të realizohet edhe në bashkëpunim ose bashkëveprim me subjekte të tjera por nën përgjegjësinë apo aprovimin e UPA për vlefshmërinë e programit.
- c) vlerat e krediteve për trajnim profesional si njësi matëse për trajnim të vazhdueshëm.

3. Profesionistët që nuk mbrojnë titullin sipas përcaktimeve të këtij neni i nënshtrohen penaliteteve të përcaktuara në Rregullore.

KREU VIII

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Neni 24

Zgjedhjet në UPA

1. Zgjedhja e organeve të UPA, bëhet të Dielen e parë të muajit [...] në [...].
2. Zgjedhjet bëhen me votim të fshehtë dhe me fletë votimi me koalicion kandidatësh ose me kandidat të pavarur.
3. Për procesin e zgjedhjeve është i lejuar edhe votimi elektronik.

Neni 25

Dispozitat kalimtare

1. Financimi i UPA për një periudhë 1 (një) vjeçare të kreditohet nga shteti ose nga Shoqata e Arkitektëve të Shqipërisë (SHASH).
2. Të gjithë arkitektët që ushtrojnë profesionin e lirëtë tyre, do të vazhdojnë ta ushtrojnë atë 2 (dy) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kohë e domosdoshme për ngritjen e Këshillit Kombëtar të UPA dhe paisjen me dokumentin përkatës.
3. Ministria Kompetente ngarkohet të ngrëjë një komision teknik të përkohshëm, detyra e të cilit është të vëzhgojë zgjedhjet e para të Këshillit Kombëtar të cilat do të organizohen nga SHASH. Këto zgjedhje do të bëhen brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data që ky ligj hyn në fuqi.
4. Ministria Kompetente brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga krijimi i UPA kalon arkivin e licencave në dispozicion të UPA-it me të gjithë infrastrukturën fizike dhe njerëzore që ka, si dhe garanton akomodimin e strukturave të tij pranë saj apo në ambiente të tjera të siguruar prej saj për të garantuar funksionim normal të strukturave të UPA.
5. Të gjitha aktet ligjore në fuqi që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 26

Dispozitat e fundit

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave, që në zbatim të këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ministria Kompetente, e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencave dhe Ministria e Financave, ngarkohen të përcaktojnë përbërjen dhe mënyrën e funksionimit të strukturave përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

Ky ligj hyn në fuqi 6 (gjashtë) muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I